



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi

Mbledhja nr. 45

Prishtinë, më 26.11.2018, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Valentina Bunjaku – Rexhepi, Driton Çausi, Abdyl Salihu dhe Albulena Balaj – Halimaj.

Munguan: Mufera Shinik, Arbërie Nagavci, Fidan Rekaliu, Verica Çeraniq dhe Nezir Cocaj.

Përfaqësues tjerë: Betim Jahaj-MKRS dhe përfaqësues të mediave.

Stafi mbështetës i Komisionit: Shaip Goxhuli dhe Lule Ymeri.

Për këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-119 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/22 për Kinematografinë;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-121 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-097 për Bibliotekat;**
- 5. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-119 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/22 për Kinematografinë;

Ismajl Kurteshi, tha se Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Kinematografinë ka kaluar në lexim të parë dhe tani jemi në fazën e shqyrtimit dhe amendamentimit.

Betim Jahaj, përfaqësues i MKRS, tha se qëllimi i ndryshimit dhe plotësimit të ligjeve nga fusha e kulturës, rinisë dhe sportist dhe konkretisht Projektligjit për Kinematografinë ka të bëjë ekskluzivisht me harmonizimin me dispozitat e Ligjit për kundërvajtje për sa i përket gjobave.

Driton Çausi, në diskutimin e tij përmendi vërejtjet nga shoqëria civile, në lidhje me nenin 2 të projektligjit, që i referohet ndryshimit të nenit 55 të Ligjit bazik, me të cilin parashihet zvogëlimi i gjobës nga 120.000 euro, në 20.000 euro maksimumi, është jo drejtë sepse gjoba e ulët prej 20.000 euro, siç parashihet në projektligj mund ta mundësojë ndërrimin e veprimtarisë së kinemave.

Teuta Haxhiu, tha se parimisht është për harmonizimin e këtyre projektligjeve me Ligjin për kundërvajtje, mirëpo, tha se ka informacione se Ligji për kundërvajtje është në procedurë të ndryshimit dhe plotësimit dhe nëse një gjë e tillë ndodhë, atëherë a nënkupton kjo se duhet edhe njëherë të bëhet ndryshimi dhe plotësimi i këtyre ligjeve, prandaj, lidhur me këtë kërkoj sqarim nga përfaqësuesi i MKRS-së, në rast se ka ndonjë informacion.

Valentina Bunjaku-Rexhepi, tha se është kundër propozimit për uljen e gjobave ngase këtë gjobë mund ta përballojë secili biznes privat, kur kemi parasysh se nga ndërrimi i veprimtarisë mund të përfitojnë shumë më shumë bizneset. Një rast i tillë ka ndodhur në komunën e Gjilanit, ku është privatizuar kinemaja dhe në vend të saj është ndërtuar objekti i banimi.

Ismajl Kurteshi, tha se parimisht pajtohet me harmonizimin e ligjeve, mirëpo sa i përket këtij projektligji, tha se është kundër zvogëlimit të gjobës e cila është propozuar nga ministria. Ai tha se Komisioni ka për obligim që t'i mbrojë objektet në të cilat zhvillohen aktivitete të kulturës, ndërsa me zvogëlimin e gjobës, shumë lehtë mund të ndryshojë veprimtaria e këtyre objekteve.

Albulena Balaj-Halimaj, tha se është obligim i komisionit shqyrtimi i këtyre projektligjeve dhe harmonizimi i tyre me Ligjin për kundërvajtje, sikurse është vepruar edhe me projektligjet tjera.

Anëtarët e komisionit vazhduan me shqyrtimin nen për nen të projektligjit, ku u diskutuan disa propozim- amendamente, të cilat ishin të karakterit teknik dhe gjuhësor.

Pas diskutimeve të anëtarëve të komisionit, në lidhje me nenin 2 të Projektligjit, që i referohet nenit 55 të Ligji bazik, kryesuesi hodhi në votim nenin 2 të projektligjit që ka të bëjë me zvogëlimin e gjobës të fshihet.

Për këtë propozim ishin 3 (tre) vota për dhe 3 (tre) vota kundër.

Ismajl Kurteshi, tha se bazuar në rezultatin e votimit, ky projektligj nuk kalon, ngase nuk ka vota të mjaftueshme.

Teuta Haxhiu, kërkoi sqarime në lidhje me interpretimin e rezultateve të votimit.

Si rezultat i mospajtimeve, mbledhjen e lëshuan dy anëtarët e komisionit, andaj kryesuesi e ndërpreu mbledhjen në mungesë të kuorumit.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Ismajl Kurteshi